

Prof. Shefik Osmani - Tiranë

HAP I RI DREJT ARTIT TË MUHAMET ÇAMI-KYÇYKU (1782– 1844)

Shpupurishja nëpër skedare të disa bibliotekave dhe të disa arkivave private më çuan te veprat e Muhamet Çamit, të shkruara dy shekuj më parë. Tematikë e kohës së shkuar, pasqyrë e shekujve XVIII-XIX. Çamërishte e bukur shqipe, e pasur, që me veshjen e saj artistike paraqet problematikë sociale, psikologjike, urbane, që ngrit autorin në rangun e një figure poligonale në qendër të shoqërisë çame, që e njeh edhe me një emër tjetër: M. Kyçyku. I denjë për t'u rimarrë i ridimensionuar nga pena mjeshtërore e një studiuesi të traditës dhe për t'u gdhendur në përjetësi nga dalta e një ustai të skulpturës, ky përfaqësues duhet të zërë vendin që i përket në historinë e kulturës shqiptare.

Vargjet e veprave të tij më sollën përpara, si në ekran, malin e Milesë, në rrëzën e të cilit shtrihet Konispoli, vendlindja e Çamit, shkollën e mesme të tij ku këndohej mevludi shqip, varganet e gjatë të mërgimtarëve të varfër shqiptarë që tjetërsoheshin në dhe të huaj, ateneun e famshëm të Al-Az'harit, ku ai bëri studimet e larta.

Bir i një familjeje të pasur, Muhameti, pasi mbaroi studimet brenda vendit, vazhdoi edhe dhjetë vjetë të tjerë jashtë, ku u formua nga ana intelektuale dhe përvetësoi tri gjuhët klasike të Lindjes islame: arabishten, persishten, turqishten e periudhës osmane. U kthye në vendlindje në moshë të pjekur dhe i ditur, plot ëndrra për ta bërë shkollën e Konispolit qendër kulture, për ta çuar përpara veprimtarinë artistike në vendlindje, për t'i bërë pasardhësit e tij besimtarë të denjë dhe qytetarë të përkorë.

Në vendlindje ai gjeti zanafillën e një tradite artistike në formim, që lidhej me dy emra vjershëtorësh: Nezim Beratin dhe Hasan Zyko Kamberin, autorë gazelesh, kasidesh dhe divanit shqip. Gjeti gjithashtu një medrese madhështore, ku mësimet zhvilloheshin në gjuhë të huaj, por të paktë ishin nxënësit që i zotëronin ato. Nxënësit flisnin shqip, por shkruanin me alfabet arab. Edhe ai vetë nuk pati dijeni për ndonjë alfabet tjetër që mund të përballonte tërë tingujt e gjuhës shqipe.

M. Çami-Kyçyku iu kushtua krijimtarisë artistike, përshtatjeve, përkthimeve në gjuhën amtare, pa ndonjë përpjekje për të zgjidhur problemin e alfabetit, nga e majta në të djathtë, që e mbrojti më vonë atdhetari i tij Hasan Tahsini.

Duke mos pasur angazhime ekonomike, u mor me njohjen e folklorit nga i cili huazoi vargun e tij 8-rrokësh, shprehjet e tij karakteristike dhe në bazë të tërë krijimtarisë së tij letrare vuri dialektin çam. Krijoi bibliotekë personale, ku shquanin veprat e teologjisë islame, ato artistike si të Firdusit (Firdavsi), Xhamiut, Al-Busirit etj. Bëri për vete një varg studentësh që u përpoqën ta shëmbëllojnë ustain e tyre dhe shkroi, sipas të dhënave të besueshme, 17 vepra që e përfaqësojnë opusin e tij. Ky opus ngërthen novelën artistike, poemën e gjatë, pamfletin, panegjrikën, veprën agjeografike, temën fetare etj.

Vokacioni i mësuesit u përpunua tek ai gjatë studimeve 21-vjeçare që bëri për teologji e filozofi. Ai iu përkushtua profesionit të mësuesit për 34 vjet dhe arriti piketa të larta: letërsisë shqipe i dha të parën novelë artistike, gjuhësisë shqipe të folmen e punuar çame, si gjuhë mësimi në shkollën shqipe, aljamiadës opusin e tij të madh, traditës një përfaqësues të shquar, Konispolit emrin dhe veprën e tij.

Vepra e tij i ngjet një poliedri ku shquan sidomos poeti, gjuhëtari, pedagogu, tekstologu dhe sociologu. Le ta analizojmë në këtë fokus këtë poliedër të shoqërisë shqiptare të shekullit XVIII-XIX.

Muhamet Çami - Poet

Vendlindja e poetit që vendi i ekstremeve, por njëkohësisht edhe gurrë e pasur e krijimtarisë popullore. Folklorin e saj e frymëzonin nga njëra anë blegtorët e shumtë që endeshin bjeshkëve nëpër pllaja e bashtina dhe çukave e gërxheve, të shoqëruar nga kopetë e tyre, duke kërkuar kullota, kurse nga ana tjetër muhaxhirët që ndërmerrnin rrugët e gjata të mërgimit plot vuajtje të papritura të përtej detit, duke kërkuar një jetë më të mirë. M. Çami që i ndjeshëm, natyrë kureshtare, i bindur ndaj principeve të shoqërisë që përfaqësonte, edukator në misionin e tij. Ai u mbërthye pas problemeve që tronditnin shoqërinë e tij, mjediset me të cilët përballej çdo ditë.

“Erveheja” është një pjellë e këtij preokupimi. Është modeli i gruas që ëndërronte të edukonte M. Çami, ashtu siç është “Jusufi” te poema “Jusufi dhe Zelihaja”, modeli i mashkullit.

Në rreth 900 vargje novela “Erveheja” bën hapin e parë në këtë gjini të letërsisë sonë. Me botimin e saj më 1888 nga Jani Vretoja në Bukuresht, ajo u bë libri më i lexuar gjatë periudhës së Rilindjes sonë. Më vonë ajo tërhoqi edhe skenën e teatrit. Më 1967 u shfaq në skenën e teatrit të Prishtinës, kurse pesë vjet më vonë edhe në atë të Tiranës. Vepra e M. Çamit i kishte rezistuar kohës. Nga shkrimtarët e vjetër shqiptarë M. Çami (pas dramës “Besa” të S. Frashërit) është nga të rrallët që u duartrokit nga publiku artdashës.

Subjekti i novelës “Erveheja” nuk është origjinal, por i përpunuar. Për burimin e huazimit të këtij subjekti janë bërë disa hamendësime. Të gjitha këto të çojnë në thesarin letrar të Lindjes. Autori shqiptar e përpunoi fabulën

e saj. I dha jetë asaj, duke e paraqitur atë në mjedisin tonë, duke i veshur Ervehesë petkun moral që aspirojnë të gjitha vendet e globit dhe duke e bërë këtë novelë një vepër letrare me përmasa të gjera.

Në rreth 900 vargje tetërrokëshe, Erveheja, protagonistja e novelës, na paraqitet e hijshme, e mençur, besnike, me karakter të fortë, stoike. Vepër është e pasur me figura letrare, me personazhe që përfaqësojnë botë psikologjike të tyre, që kanë bindje vetiake, që gjenerojnë qëndrime heroike, ndonëse paraqesin kontraste në karaktere.

Jani Vretoja, pasi u bind për vlerat e saj artistike në variantin e përpunuar të Hajdar Argjirokastritit, e çliroi edhe më nga fjalët e huaja dhe e botoi më 1888 në Bukuresht, në Shypshkronjën e Shoqërisë “*Ditura*”, ku ishin botuar edhe një varg vepërash të tjera në gjuhën shqipe. Në letërkëmbimin e tij me Sotir Kolenë, ai shprehet se i pëlqeu shumë kjo vepër, se “e qëroi nga fjalët e huaja”, se kjo vepër ka emocionuar të gjithë ata që e kanë lexuar, se e ka botuar me tirazh të lartë dhe se interesohet për të dërguar disa kopje edhe në Elbasan e Pogradec.

Një vepër tjetër me rëndësi e M. Çamit është edhe poema e gjatë “*Jusufi dhe Zelihaja*”. Subjekti i kësaj poeme është huazuar nga “*Suretu Jusuf*” e Kur’anit. Natyrisht në poemë merr ngjyra letrare, por pa devijuar rolin edukativ islam. Konstruktiv artistik i shërbejnë: gjuha, epitetet, figurat letrare, fenomenet psikologjike të shumëllojshme dhe ato etiko-edukative. Një galeri e tërë personazhesh paraqitet në këtë poemë.

Këtu ndeshet e mira me të keqen, e drejta me padrejtësinë, e vërteta me gënjeshtrenë. Poema e ushqen vazhdimisht lexuesin me bindjen se në këtë luftë të vazhdueshme, fitimtare do të dalë e vërteta, e drejta, e mira. Jusufi, protagonist i poemës, është shëmbëlltyrë e stoikut që sfidon krimin, vuajtjet, kurthet. Stoicizmi i tij është proverbial. Vullneti i tij i hekurt. Besimi në drejtësinë, që vonon por nuk harron, është i patundur. Madhështia e personalitetit të tij shkon në rritje kur paraqit kapërcimin e tradhëtisë të të afërmeve të vet, kur përballon tundimin seksual që i shkakton Zelihaja, kur me stoicizëm të pashembulltë i tejkalon vuajtjet e burgut të pamerituar.

Vlerat e saj artistike dhe etike janë bërë objekt interesi për shumë studiues shqiptarë dhe të huaj.

Kemi dijeni se kjo temë është trajtuar edhe shumë kohë më parë. Në Arkivin e Shtetit (Tiranë) ekzistojnë disa dorëshkrime të shkruara shqip, në vargje dhe në prozë, me shkronja arabe, që kanë për subjekt “*historinë e Jusufit (a. s.)*”, duke iu referuar Kur’ani Kerimit. Një nga këto dorëshkrime daton 1035/1625, d.m.th. një shekull e gjysmë para lindjes së M. Çamit ose më se dy shekuj para vdekjes së tij. Pikërisht me këtë dorëshkrim lind një problem: rishikimi i datëfillimit të aljamiadës shqiptare. Nëse ky dorëshkrim i autorit Rustem Efendi, nga Gorica (Korça) jep të dhëna për kohën kur është përgatitur, për vendin ku do të shfrytëzohej, për destinacionin ku do të përdorej, për dialektin në të cilin është shkruar, atëherë do të mund të

zbërthehen një varg pikëpyetjesh me rëndësi për këtë problem.

Me problemën e aljamiadës tonë janë marrë: Osman Myderrizi, Hasan Kaleshi, Dhimitër Shuteriqi, Mahmud Hysa, Muhamet Piraku, Rexhep Ismaili, Shaban Çollaku, Robert Elsie etj.

Një variant të “*Jusufi e Zelihaja*” e botoi më 1992 në Tiranë, Ibrahim D. Hoxha, i cili ruan edhe veprat e tjera të M. Çamit.

Muhameti Çami - Gjuhëtar dhe pedagog

M. Çami-Kyçyku filloi punën si mësimdhënës në shkollën e mesme të Konispolit rreth vitit 1809-1810. Aty vazhdoi si mësues për më se tridhjetë vjet, duke lënë gjurmë dhe duke krijuar traditë kryesisht si pedagog dhe si gjuhëtar. Kontributet e tij duhen vlerësuar në optikën kontekstuale lidhur me kohën, rrethanat dhe nivelet.

E rëndësisë së dorës së parë është nisma e tij për të përdorur tekstet në gjuhën e folur shqipe si teskte mësimi. P.sh. “*Mevludi*”, i përpunuar nga ai në gjuhën shqipe, zhvillohej si lëndë mësimi në shkollën ku jepte mësim (medrese). Në të njëjtin plan duhet vlerësuar edhe poema “*Jusufi dhe Zelihaja*”, e cila shfrytëzohej nga studentët e tij për të kuptuar më lehtë tekstin e sures së XII të Kura’nit. Ai shkroi me alfabet arab dhe bëri disa përpjekje për të plotësuar kërkesat që ka shqipja ndaj zanoreve. Ai zotëronte greqishten, por nuk dimë a ka ndikuar kjo në këtë drejtim. Nuk kemi ndonjë të dhënë se a ka njohur M. Çami-Kyçyku gjuhë të tjera europiane.

Duke iu referuar përsëri fondeve që disponon Arkivi i Shtetit - Tiranë¹, njoftohemi se ekziston një numër i konsiderueshëm tekstesh mësimore të gramatikës së gjuhës arabe, që përdorshin në shkollat e asaj kohe.

Disa të dhëna dëshmojnë për vokacionin e tij si pedagog dhe gjuhëtar. Si pedagog, në krahasim me të tjerët, ai bëri një hap përpara duke komunikuar shqip, duke shkruar shqip, duke u shprehur me një gjuhë artistike dhe me një fjalor të pasur të të folmes çame. Si pedagog ai zgjeroi horizontin intelektual të nxënësve, si gjuhëtar zgjeroi gamën e njohurive, duke i shtuar gjini të reja divanit të Nezimit dhe vjershave të Hasan Zyko Kamberit.

M. Çami-Kyçyku megjithë përgatitjen e tij të gjerë linguistike, nuk kapi dy fusha kryesore as si pedagog e as si gjuhëtar: njëra i përket përdorimit të fjalëve të huaja, në mjaft raste të panevojshme, të cilat vazhdonin ta molepsnin gjuhën amtare, kurse tjetra e mospërpunimit të një alfabeti, që t’i përgjigjej plotësisht të 36 tingujve të gjuhës shqipe, siç u përpoqën më vonë Hasan Tahsini me të tjerë.

Muhamet Çami - tekstolog

¹ “Katalogu i dorëshkrimeve osmane në arkivat e Shqipërisë”. Ankara, 2001.

Në periudhën e sundimit osman shumëllojshmëria e shkollave në trevat shqiptare qe një dukuri e rëndomtë. Kishte shkolla si: mejtepe, medrese, ruzhdiye, idadiye, darulmualimin, etj. (për muslimanët), shkolla famullitare, pravosllave, episkopale, metropolitane etj. (për ortodoksët), shkolla, kolegje, gjimnaziume (për katolikët). Në përgjithësi, shekuj me radhë, në të tëra këto shkolla mbizotëronin gjuhët e huaja, vetëm gjuha shqipe jo.

Tekstet mësimore që përdornin këto shkolla ishin në gjuhë të huaj. Në këto kushte rendimentet qenë të pakta e të vonuara. Të paktë ishin edhe nxënësit që arrinin të vazhdonin më lart.

M. Çami, me formimin intelektual që kishte, nuk u pajtua me gjendjen ose nivelin dhe administrimin e medresesë ku filloi të punonte. Ai i pa pasojat që sillte në formimin e botëkuptimit islam mungesa në kohën e duhur e përdorimit të gjuhës së folur shqipe, mungesa e teksteve në gjuhën amtare. Kështu ai hartoi "*Mevludin*" shqip, që ndofta është i pari tekst shkollor shqip i asaj kohe. Nëpërmjet këtij libri shqip, që kuptohej, mësohej, përvetësohej përmendsh dhe këndohej në kor nga nxënësit, filloi "modernizimi i procesit mësimor që kërkonte shkolla".

Ky proces shënoi një hap të madh përpara, sepse i bëri nxënësit të ndërgjegjshëm për atë që lexonin, sepse duke lexuar në gjuhën amtare kuptonin shumë më përpara kush ishte profeti, çfarë përfaqësonte Ai, çfarë kuptohej me "Vit i pikëllimit" e kështu me radhë.

Ai hartoi tekstin "*Jusufi e Zelihaja*", për të cilin ka të dhëna se u përdor si tekst mësimor. Në kushtet e shoqërisë së asaj kohe, e gjithë krijimtaria letrare e tij, që u rishikua, u kopjua, u lexua, shërbeu si tekst mësimor. Siç e thamë më sipër, nuk kemi të dhëna tashti për tashti për tekstin e gramatikës nëse është vepër e tij apo jo. Jemi të bindur se një studim më i thelluar rreth kontributit të tij, jo vetëm në fushën e letërsisë, por edhe në atë të pedagogjisë, ku ai ka shërbyer kryesisht, do të jepte të dhëna të rëndësishme për vendin që zë M. Çami në atë zonë.

Muhamet Çami - sociolog

Në shoqërinë shqiptare konispolase të shek. XVIII-XIX gëlonin probleme të shumta sociale: varfëria ekonomike, plaga e rëndë e e pandarë e gurbetit, përhapja e veseve negative si ajo e alkoolizmit, prapambetja, botëkuptimi i prapambetur etj. Përballë kësaj maxhorance, shoqëria konispolase kishte një pakicë intelektuale, burim i së cilës ishte shkolla ose medreseja ku jepte mësim edhe Muhamet Kyçyku.

Si pjesëtar i kësaj shoqërie, ku ai bënte pjesë si teolog që e preokuponte formimi botëkuptimor i besimtarëve; si pedagog i shkollës që gëzonte emër të mirë në tërë zonën, ishte i preokupuar për gjendjen, prandaj e diagnostikoi atë, përcaktoi qëndrimin e tij dhe veprimi si vais, si mësues, si pamfletist. Shkroi dy pamflete: "*Alkooli*" dhe "*Gurbetllinjte*", që janë dy

sinjale të fuqishme të alarmit shoqëror të kohës. Të dyja këto plagë ai i përshkroi lidhur me shoqërinë në tërë gamën e tyre: nga ana ekonomike, nga ana morale, nga ana e marrëdhënieve shoqërore. Tregoi pasojat e alkoolizimit, rrjedhimet e emigrimit. Duke lexuar këto pamflete të del përpara një botë e varfër, njerëz të hidhëruar, familje që vuajnë, individë të pezmatuar që i ndjek nga pas dhimbja, konispolas të brengosur që plandosen nëpër mejhane duke u dehur me verë e raki, duke u shamatuar, duke u grindur, duke u vrrarë. Dhe pas këtyre moralizimet.

xxx

Gjatë shekujve XVIII-XIX në disa qendra shqiptare si në Shkodër, Berat, Prizren, Elbasan, Shkup, Prishtinë etj mori zhvillim tregtia, zanatet dhe punishtet e metaleve, drurit, leshit etj. të cilat u bënë faktorë pozitivë për shtytjen e lëvizjes kulturore në mjediset e tyre. Në këto qendra ku funksiononin shkolla në rangun e medreseve, u aktivizuan në lëvizjet kulturore edhe studentët që kishin bërë studimet në Stamboll, Kajro etj.

Intelektualë të formuar në drejtime teologjike, kulturore, letrare, artistike etj. si Muhamet Çami-Kyçyku, i dhanë një impuls të ri shoqërisë së përgjumur mesjetare, sidomos duke shkruar gjuhën shqipe, në atë gjuhë që komunikonin tërë shtresat e shoqërisë shqipfolëse. Novela, poema e gjatë, pamfletet etj. e pasuruan fondin e librit shqip. Në mungesën e shtypshkronjave ata i shumëfishonin me anë të qatipëve (shkrues profesionistë) veprat e tyre duke i bërë të njohur plagët, kontradiktat, adhurimet etj. që përshkonin shoqërinë shqiptare.

Në shekullin XIX numri i atyre që shkruanin në gjuhën amtare me alfabet arab ishte shtuar ndjeshëm. Në këtë dukuri duhen parë dhe disa rrjedhime. Shtimi i lexuesve, tematika gjithnjë e më shumë shoqërore, e mbi të gjitha, formimi i një koncepti bashkëkohor, një koncepti të ri botëkuptimor për rolin e shkrimit në gjuhën amtare, që lidhej me një sërë pikëpamjesh, parimesh dhe interesash.

Shkrimtarë si Nezim Frakulla, që krenoheshin se po e bënë shqipen “bejan” (stil artistik), si Muhamet Çami që theksonte se bejtet po i bëjmë shqip etj., provonte se shqipja është një gjuhë e pasur me shprehje dhe fjalor për të transmetuar mesazhe artistike dhe filozofike, se ajo afirmonte rrugën drejt identitetit si komb.

BIBLIOGRAFI

- Akademia e Shkencave – Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë (Grup autorësh nën drejtimin e Prof. Dh. Shuteriqit). *Historia e Letërsisë Shqiptare*. Tiranë, 1993.
- Azemi, Emin – Halimi, Shkëlzen. *Shqiptarët e Egjiptit*. Shkup, 1993.
- Çami, Muhamet. Erveheja-vjershuarë prej Muhamet Çamit. Mbaruarë prej Hajdar Argjirokastritit edhe qëruarë fjalët’ e huaja prej J. Vretosë. Shtypurë ndë shtypëshkronjëtoreset të Shoqërisë “Dituri” ndë Bukuresht, 1888.
- Çami, Muhamet. Jusufi dhe Zelihaja. Tiranë, 1992.
- Çollaku, Shaban. *Historia e letërsisë shqipe nga fillimet deri në vitin 1939*.
- Elsie, Robert. *Historia e letërsisë shqiptare*. Pejë, 1997.
- Hoxha, Ibrahim. Medreseja e Konispolit. Në buletin “Qytetërimi Islam”. Tiranë, 1999, Nr. 14.
- Hysa, Mahmud. *Alhamiada shqiptare*. Studime letrare. Shkup, 1997.
- Hysa, Prof. Dr. Mahmud. Hyrje në letërsinë shqiptare. Prishtinë, 2000.
- Inalçik, Halil. *Perandoria osmane*. Shkup, 1995.
- Ismaili, Rexhep. *Tekste të vjetra*. Botues “Dukagjini”. Pejë, 2000.
- Kaleshi, Hasan. *Kontributi i shqiptarëve në diturinë islame*. Riad, 1992.
- *Katalogu i dorëshkrimeve osmane në arkivat e Shqipërisë*. Ankara, 2001
- Mufaku, Dr. Muhamed. *Shqiptarët në botën arabe*. Prishtinë, 1990.
- Myderrizi, Osman. *Letërsia shqipe me alfabet arab*. Në “Buletin për shkencat shoqërore”. Viti 1951, Nr. 1, 1955, Nr.2.
- Naska, Kaliopi. *Çamëria*. Tiranë, 1999.
- Osmani, Shefik. *Panteoni iranien dhe iranologët shqiptarë*. Tiranë, 1998.
- Osmani, Tomor. *Udhë e shkronjave shqipe*. Shkodër, 1999.
- Pirraku, Dr. Muhamet. *Kultura kombëtare shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit*. Prishtinë, 1989.
- Saliku, Mr. Hajdar. *Poezia e bejtexhinjëve*. Prishtinë, 1987.
- Shuteriqi, Dhimitër. *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*. Tiranë, 1976.
- Instituti Shtetëror i Tiranës – Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë. *Historia e Letërsisë Shqipe*. Tiranë, 1959.

Prof. Shefki Osmani

Muhamet Çami
Summary

During the 18th and 19th century there was a development of trade and craftsmanship in many Albanian centers such as: Shkoder, Berat, Prizren, Shkup, Elbasan etc. Many cultural movements were born in these centers and staff who had completed their studies in the most prominent cultural and educational world centers such as Istanbul, Kajro and others were involved in them.

These intellectuals, amongst who is Muhamet Cami (1778-1884) gave a new boost to society in the cultural and literary aspect. ...

This contribution talks about some aspects not well known so far of the poet M. Cami, who said that "bejtet are being made in Albanina". This proves that the Albanian language is a rich language with expressions to convey artistic and philosophical messages from the world literature. By doing so, he affirmed the path towards the Albanian national identity.